

V E N D I M
Nr.22, datë 21.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli, Anëtar i “““

Manol Konomi, Anëtar i “““

Feti Gjilani, Anëtar i “““

Veli Budo, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Zija Vuci, Anëtar i “““

Franc Jakova, Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, në datën 20.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.29 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S E : PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE, e përfaqësuar nga Z. Arben Demeti.

PALË E INTERESUAR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në mungesë.

O B J E K T I:

1. Shfuqizimi i vendimeve nr.459 Prot., datë 11.5.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përkasin kandidatëve për deputetë të Partisë Aleanca Demokratike, Z. Arban Hasani dhe Jakup Mehmetaj.

2. Shfuqizimin e Vendimit nr.452 Prot., datë 10.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përket kandidatit për deputet të Partisë Aleanca Demokratike, Z. Zeqir Veliu.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1. Komisionet e Zgjedhjeve të Zonave nr.8 dhe 1, pasi i kanë gjetur në pajtim me Ligjin Nr. 7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr.8055, datë 1.2.1996, dokumentet e paraqitura nga Partia Aleanca Demokratike për zz. Arban Hasani dhe Jakup Mehmetaj, kanë marrë vendimet përkatëse dhe i kanë regjistruar ata si kandidatë për deputetë - të parin në zonën e zgjedhjeve nr.8 dhe të dytin në zonën e zgjedhjeve nr.1.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke ushtruar kontroll për regjistrimin e kandidatëve në zona sipas shkronjës “d” të nenit 36 të Ligjit, me vendimet nr. 459 prot. dhe nr. 460 prot., datë 11 maj 1996 ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të komisioneve të zonave nr. 8 dhe nr. 1, me arsyetimin se në dokumentacionin e paraqitur për të dy kandidatët “mungon vendimi i komisionit të verifikimit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Gjykata konstaton se ekzistojnë vendimet datë 9 prill 1996 për kandidatin për deputet z. Arben Hasani dhe datë 18 prill 1996 për kandidatin për deputet z. Jakup Mehmetaj, të lëshuar nga Komisioni Shtetëror për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka quajtur ato të paqena, për shkak se nuk janë paraqitur në origjinal, por në kopje të vërtetuara nga noteret.

Kopjet e vendimeve të paraqitura nga pala kërkuuese, të vërtetuara rregullisht nga noteria, janë të barazvlefshme me origjinalet dhe përbëjnë dokumente zyrtare me vlerë të plotë. Sipas shkronjës “f” të nenit 39 të Ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, noteri “vërteton se kopjet ose shkurtimet e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit”.

Në këto rrethana, Gjykata e gjen të bazuar kërkesën e Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimeve nr.459 Prot., datë 11.5.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Me vendimin datë 30.4.1996 komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.107 ka refuzuar regjistrimin e Z. Zeqir Veliu si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike me arsyetimin se “në listat e zgjedhësve janë vërejtur parregullsi të theksuara, si p.sh. firma të falsifikuara, firma të vëna nga persona që nuk janë firma të tyre, veprime si emra të shkruara dy herë si dhe veprime të tjera që nuk janë në përshtatje me ligjin”.

Mbi ankimin e Partisë Aleanca Demokratike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.452 Prot., datë 10.5.1996 ka vendosur “rrëzimin e ankimit duke lënë në fuqi vendimin e komisionit të zonës nr.107”. Në këtë vendim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shprehet se : “nga komisioni i zonës janë konstatuar parregullsi në listat e 400 përkrahësve ndonëse është respektuar afati 48 orë për t’i korrigjuar”.

Në listat e përkrahësve të kandidatit Zeqir Veliu, janë krejt të dukshme shumë raste që një person ka firmosur për dy ose më shumë persona të tjerë, ç’ka tregon jo vetëm parregullsi në plotësimin e listave, por edhe veprime që vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e paragrafit të parë të nenit 14 të ligjit, i cili përcakton se çdo zgjedhës duhet të vërë vetë nënshkrimin në listë.

Përsa i përket vërtetimit nr.4, datë 26.4.1996 për regjistrimin e Z.Zeqir Veliu si kandidat për deputet i Partisë Aleanca Demokratike në zonën nr.107, Gjykata çmon se kryetari dhe sekretari i komisionit të zonës e kanë lëshuar atë në kuptimin e pranimit të dokumenteve për shqyrtim. Ky konkluzion rrjedh nga fakti se nuk mund të merrej nga komisioni i zonës më datë 26.4.1996 vendim për regjistrimin e kandidatëve për deputetë, kur mbledhjen për marrjen e vendimit komisioni e ka zhvilluar më 30.4.1996.

Në këto rrethana Gjykata çmon se kërkesa e Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.452 Prot., datë 10.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 50 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr.8055, datë 1.2.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimeve nr.459 Prot., datë 11.5.1996 dhe nr.460 Prot., datë 11.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.8 të regjistrojë dhe të shpallë menjëherë si kandidat për deputet të Partisë Aleanca Demokratike Z. Arban Hasani;

Komisioni i zgjedhjeve i zonës nr.1 të regjistrojë dhe të shpallë menjëherë si kandidat për deputet të Partisë Aleanca Demokratike Z. Jakup Mehmetaj.

2. Rrëzimin e kërkesës së Partisë Aleanca Demokratike për shfuqizimin e vendimit nr.452 Prot., datë 10.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 21.5.1996

Nr. 29 i Regjistrimit themeltar.

Nr. 22 i Vendimit.